

V E N D I M
Nr.130, datë 18.3.1999

**PËR INSPEKTORATIN SHETETËROR TË KONTROLLIT TË NAFTËS, GAZIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe të nenit 23 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me propozimin e Ministrisë Ekonomisë Publike dhe Privatizimit”, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Të krijohet Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre, si organ shtetëror i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, si dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre është në vartësi të Ministrit që mbulon veprimtarinë hidrokarbure.

3. Përbërja dhe funksionimi:

a) Inspektorati drejtohet nga Kryeinspektori i cili emërohet nga Ministri. Në përbërje të Inspektoratit janë inspektorët dhe punonjësit e Laboratorit Qendror të Kontrollit.

Inspektorati është shtetëror jobuxhetor. Ai ka qendrën e vet në Tiranë. Inspektorati ka inspektorët pranë qarqeve, sipas organizimit të qeverisjes vendore. Struktura dhe numri i punonjësve në organikë të Inspektoratit përcaktohet nga Ministri.

c) Inspektorati ushtron veprimtarinë e kontrollit për zbatimin e kushteve të parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse, që u janë dhënë personave juridikë, në instalimet, impiantet dhe pajisjet e përdorura, në mënyrë që ato të respektojnë normat teknike të masave mbrojtëse ndaj zjarrit, treguesit cilësorë, standardet shtetërore dhe dispozitat ligjore e nënligjore, për të parandaluar abuzimet dhe falsifikimet që mund të kryhen nga personat juridikë.

ç) Në përbërje të Inspektoratit është Laboratori Qendror i Karburanteve, i cili funksionon në bazë të rregullores së miratuar nga Ministri, si dhe administrimi i depove portuale të naftës e nënprodukteve të tyre.

d) Kryeinspektori varet e raporton për veprimtarinë e Inspektoratit para Ministrit. Për efekt page ai barazohet me Drejtorin e Drejtorisë Përgjithshme, ndërsa inspektorët dhe përgjegjësi i Laboratorit me atë të shefit të sektorit në Ministri. Punonjësit e tjerë klasifikohen si specialistët dhe punonjësit analogë në Ministri.

dh) Vetëm kur merret në konsideratë varianti i dytë i pikës "b" inspektori i mbulon shpenzimet e veta me të ardhurat që sigurohen dhe depozitimet e karburanteve e të lëndëve djegëse në depot portuale, nga kryerja e analizave periodike e të detyrueshme për cilësinë, si dhe nga çdo shërbim tjetër ndaj personave të tretë në bazë të dispozitave ligjore. Bilanci i të ardhurave e i shpenzimeve të Inspektoratit miratohet nga Ministri. Tepricat e rezultuara në fundin e çdo viti kalojnë në buxhetin e shtetit.

4. Detyrat e Inspektoratit Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit e Nënprodukteve të tyre janë:

a) Të kontrollojë zbatimin e dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” nga të gjitha subjektet shtetërore apo private dhe të marrë masat përkatëse për çdo shkelje të vënë re.

b) Të kontrollojë zbatimin e dispozitave të akteve nënligjore për kushtet teknike dhe kriteret që duhet të zbatohen subjektet që veprojnë në fushën e përpunimit, transportimit apo tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre.

c) Të kontrollojë treguesit sasiorë, cilësorë dhe markën për naftën, gazin e nënproduktet e tyre që tregtohen apo që janë gjendje në depot e subjekteve që tregtojnë me shumicë apo pakicë dhe të marrë masat përkatëse për respektimin e dispozitave ligjore.

5. Të drejtën e ushtrimit të kontrollit e kanë të gjithë inspektorët e Inspektoratit të cilët pajisen me dokument identifikimi nga Kryeinspektori. Ata kanë të drejtën e marrjes së mostrave nga çdo lloj

lëngu apo cilado depozitë e veçantë e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në bazë të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999. Marrja e mostrave bëhet pa pagesë.

Punonjësit e Labororit Qendror të Kontrollit, të pajisur me dokument identifikimi nga Kryeinspektori kanë të drejtë të ushtrojnë kontroll vetëm për sa i përket cilësisë së karburanteve apo lëndëve djegëse që tregtohen apo janë gjendje, si dhe të marrin pa pagesë mostrat përkatëse në të gjitha vendet e depozitimit, transportimit apo tregtimit të subjekteve të pajisur me leje koncesioni, leje tregtimi apo autorizime.

6. Kontrolli për cilësinë, mënyra e marrjes së mostrës dhe sasia e saj, pagesa për të, si dhe dokumentacioni përkatës përcaktohen me urdhër të Ministrit.

7. Kontrolli për respektimin e kushteve teknike dhe për cilësinë apo markën e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre kryhet në të gjitha objektet të cilat janë pronë e subjekteve të pajisura me leje koncesioni, leje tregtimi ose autorizime, si dhe në të gjitha objektet që janë marrë prej tyre me qira, në përdorim apo në çfarëdo lloj forme tjetër për përpunimin, depozitimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre.

8. Kontrolli kryhet brenda orarit të veprimtarisë së subjekteve ose të orarit të veprimtarisë në objektin përkatës. Kontrolli në objekte, depozita, impiante, stacione të shitjes apo njësi të lëndëve djegëse, mund të kryhet dhe jashtë orarit të punës, vetëm me urdhër me shkrim të Kryeinspektorit, por gjithmonë në prani të një përfaqësuesi të shoqërisë apo të personit fizik, i cili zotëron ose përdor objektin përkatës.

9. Përveç gjobës së përcaktuar në ligjin nr.8450 datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” inspektorët kanë të drejtë, kur vërejnë shkelje të kushteve teknike apo rregullave të tjera të përcaktuara në urdhërin e Ministrit, t’i kërkojnë organit përkatës heqjen e tyre.

10. Rezultatet e kontrollit pasqyrohen në procesverbal, i cili firmoset nga inspektori që ushtron kontrollin dhe nga përfaqësuesi i subjektit. Kur ky i fundit ka vërejtje, i shënon ato në procesverbal. Në rastin kur përfaqësuesi i subjektit refuzon të marrë pjesë në procesin e kontrollit apo refuzon të firmosë sipas kushteve të përshkruara më sipër, atëherë inspektori vendos shënimin “refuzon firmën”, duke e bërë kështu procesverbalin të vlefshëm. Në rastet e kërkesës për heqjen e lejes apo të autorizimit, një kopje e procesverbalit i dërgohet organit që i ka lëshuar ato.

11. Kundër masave të marra nga inspektorët në bazë të dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, mund të bëhet ankim me shkrim te Kryeinspektori, brenda 10 ditëve nga data e mbajtjes së procesverbalit. Vendimi i këtij të fundit duhet të jepet brenda një afati 10 ditor nga data e mbërritjes së ankesës në Inspektorat.

12. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimin. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko